


Tregtia e jashtme e mallrave

Qershor 2021

Tiranë, më 19 Korrik 2021: Në Qershor 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 35 mld lekë, duke u rritur me 50,8 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 6,1 %, në krahasim me Maj 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, eksportet në muajin Qershor 2021 u rritën me 38,8 %. Importet e mallrave arritën vlerën 67 mld lekë, duke u rritur me 28,9 %, në krahasim me një vit më parë dhe me 8,4 %, në krahasim me Maj 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, importet në muajin Qershor 2021 u rritën me 26,2 %. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 32 mld lekë, duke u rritur me 11,4 %, krahasuar me Qershor 2020 dhe me 11,1 %, në krahasim me Maj 2021. Krahasuar me mesataren mujore të tre viteve, 2018-2020, defiçiti tregtar në muajin Qershor 2021 u rrit me 14,9 %.

Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)




Në gjashtëmujorin e parë 2021 eksportet e mallrave arritën vlerën 177 mld lekë, duke u rritur me 40,9 %, ndërkohë importet e mallrave arritën vlerën 354 mld lekë, duke u rritur me 30,5 %, krahasuar me një vit më parë. Defiçiti tregtar arriti vlerën 178 mld lekë, duke u rritur me 21,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të 2020.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Qershor 2021, në rritjen e eksporteve prej 50,8 %, pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +20,1 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +14,9 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +4,8 pikë përqindje.

Gjatë muajit Qershor 2021, rritja e eksporteve prej 38,8 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +14,7 pikë përqindje “Materiale ndërtimi dhe metale” me +11,8 pikë përqindje, dhe “Ushqime, pije, duhan” me +5,0 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,3 pikë përqindje.

Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Qershor 2021




Eksportet, gjatë këtij gjashtëmujori janë rritur me 40,9 %, krahasuar me një vit më parë. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të eksporteve, janë: “Materiale ndërtimi dhe metale” me +13,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +13,2 pikë përqindje dhe “Tekstile dhe këpucë” me +6,3 pikë përqindje.

Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Qershor 2021, në rritjen e importeve prej 28,9 %, krahasuar me Qershor 2020, kanë ndikuar pozitivisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +8,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +4,9 pikë përqindje, “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me +4,6 pikë përqindje.

Gjatë muajit Qershor 2021, rritja e importeve prej 26,2 %, krahasuar me mesataren mujore të tre viteve (2018-2020), është ndikuar kryesisht nga grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +8,0 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,3 pikë përqindje, dhe “Ushqime, pije, duhan” me +3,7 pikë përqindje. Ndërsa grupi “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” ka ndikuar negativisht me -0,4 pikë përqindje.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Qershor 2021



Si gjashtëmujor, importet janë rritur me 30,5 %, krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2020. Grupet që kanë ndikuar pozitivisht në rritjen vjetore të importeve, janë: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +9,8 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +5,3 pikë përqindje, “Produkte kimike dhe plastike” me +4,6 pikë përqindje.

Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere


Në muajin Qershor 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Qershor 2020 janë: Italia (28,9 %), Kosova (49,1 %) dhe Greqia (115,3 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Mbretëria e Bashkuar (21,3 %) dhe Ukraina (58,4 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (31,8 %), Kosova (66,8 %) dhe Spanja (39,6 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Mbretëria e Bashkuar (27,7 %) dhe Ukraina (39,0 %).

Në muajin Qershor 2021, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Qershor 2020 janë: Italia (16,7 %), Turqia (70,3 %) dhe Kina (19,0 %). Ndërsa vendi me të cilin importet kanë pasur uljen më të madhe është: Greqia (0,8 %).

Gjatë këtij gjashtëmujori, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me një vit më parë, janë: Italia (38,5 %), Turqia (56,5 %) dhe Kina (34,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, janë: Rusia (10,7 %), Zvicra (25,2 %) dhe Ukraina (22,5 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Qershor 2021



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 60,0 %, të gjithë tregtisë. Në Qershor 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 70,0 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 54,9 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (29,4 %), Turqia (9,2 %), Greqia (6,9 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Shkëmbimet tregtare, për gjashtëmujorin e parë 2021, me vendet e BE-së zënë 61,8 % të gjithë tregtisë. Në periudhën Janar - Qershor 2021, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 72,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 56,4 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (31,4 %), Turqia (7,9 %), Greqia (7,0 %) dhe Gjermania (6,6 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Qershor 2021

| Vitet | Muajt | Eksporte (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Importe (mld lekë) | Ndryshimi Vjetor (%) | Bilanci Tregtar (mld lekë) | Mbulimi (%) |
|-------|--------------------|------------------------|-------------------------|-----------------------|-------------------------|-------------------------------|----------------|
| 2000 | | 37 | -23,5 | 157 | -1,5 | -120 | 23,6 |
| 2001 | | 44 | 19,1 | 190 | 21,0 | -146 | 23,2 |
| 2002 | | 47 | 7,7 | 210 | 10,6 | -163 | 22,6 |
| 2003 | | 54 | 14,7 | 226 | 7,4 | -172 | 24,1 |
| 2004 | | 62 | 14,0 | 236 | 4,5 | -174 | 26,3 |
| 2005 | | 66 | 6,0 | 262 | 11,1 | -196 | 25,1 |
| 2006 | | 77 | 17,6 | 299 | 14,1 | -222 | 25,9 |
| 2007 | | 97 | 25,5 | 376 | 25,8 | -279 | 25,8 |
| 2008 | | 113 | 15,8 | 440 | 16,9 | -327 | 25,6 |
| 2009 | | 105 | -7,2 | 429 | -2,5 | -324 | 24,4 |
| 2010 | | 162 | 54,6 | 478 | 11,4 | -316 | 33,8 |
| 2011 | | 197 | 21,9 | 544 | 13,9 | -347 | 36,2 |
| 2012 | | 213 | 8,2 | 528 | -2,9 | -315 | 40,3 |
| 2013 | | 246 | 15,7 | 517 | -2,1 | -271 | 47,6 |
| 2014 | | 256 | 3,8 | 552 | 6,7 | -296 | 46,3 |
| 2015 | | 243 | -4,9 | 545 | -1,4 | -302 | 44,7 |
| 2016 | | 243 | 0,1 | 579 | 6,4 | -336 | 42,0 |
| 2017 | | 273 | 12,1 | 626 | 8,1 | -353 | 43,6 |
| 2018 | | 310 | 13,7 | 641 | 2,4 | -331 | 48,4 |
| 2019 | | 299 | -3,8 | 649 | 1,2 | -350 | 46,0 |
| 2020 | | 272 | -9,0 | 605 | -6,8 | -333 | 44,9 |
| 2018 | 06 - 18 | 27 | 18,1 | 54 | -4,6 | -28 | 49,2 |
| | Janar– Qershor 18 | 158 | 18,4 | 310 | 4,7 | -151 | 51,1 |
| 2019 | 06 - 19 | 26 | -4,1 | 53 | -1,4 | -28 | 47,9 |
| | Janar– Qershor 19 | 152 | -3,6 | 318 | 2,6 | -165 | 48,0 |
| 2020 | 06 - 20 | 23 | -9,6 | 52 | -2,4 | -29 | 44,3 |
| | Janar – Qershor 20 | 125 | -17,7 | 271 | -14,6 | -146 | 46,2 |
| 2021 | 06 - 21 | 35 | 50,8 | 67 | 28,9 | -32 | 51,9 |
| | Janar– Qershor 21 | 177 | 40,9 | 354 | 30,5 | -178 | 49,9 |

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milione lekë), Qershor 2021

| | Eksporte | | | | Importe | | | |
|-----------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|---------------|----------------|----------------|
| | Qershor 2020 | Qershor 2021 | Jan.-Qer. 2020 | Jan.-Qer. 2020 | Qershor 2020 | Qershor 2021 | Jan.-Qer. 2020 | Jan.-Qer. 2020 |
| Vendet e BE-së | 17.079 | 24.400 | 94.675 | 128.080 | 30.771 | 36.868 | 155.859 | 199.784 |
| Austri | 96 | 233 | 767 | 1.135 | 429 | 629 | 2.390 | 3.158 |
| Gjermani | 1.380 | 1.819 | 8.255 | 9.510 | 3.391 | 4.962 | 21.064 | 25.630 |
| Greqi | 1.093 | 2.354 | 5.704 | 10.027 | 4.682 | 4.645 | 25.257 | 27.105 |
| Itali | 10.720 | 13.822 | 57.098 | 75.281 | 13.833 | 16.146 | 66.014 | 91.415 |
| Spanjë | 1.056 | 2.164 | 8.438 | 11.776 | 794 | 1.097 | 4.321 | 5.075 |
| Kroaci | 173 | 306 | 931 | 1.483 | 716 | 777 | 2.834 | 3.586 |
| Të tjera të BE-së | 2.561 | 3.701 | 13.483 | 18.868 | 6.926 | 8.612 | 33.979 | 43.816 |
| Mbretëri e Bashkuar | 91 | 72 | 427 | 309 | 430 | 568 | 2.405 | 2.829 |
| Kinë | 311 | 534 | 2.589 | 3.815 | 4.834 | 5.751 | 23.141 | 31.071 |
| Kosovë | 2.411 | 3.595 | 10.343 | 17.251 | 861 | 1.334 | 3.563 | 5.133 |
| Maqedonia e Veriut | 832 | 1.467 | 3.889 | 5.753 | 833 | 1.068 | 4.085 | 4.614 |
| Rusi | - | - | 6 | 8 | 853 | 1.089 | 7.969 | 7.112 |
| SHBA | 148 | 223 | 1.457 | 2.125 | 544 | 689 | 4.294 | 6.148 |
| Turqi | 250 | 473 | 1.100 | 3.028 | 5.233 | 8.910 | 25.019 | 39.143 |
| Ukrainë | 41 | 17 | 270 | 164 | 215 | 373 | 2.379 | 1.843 |
| Zvicër | 71 | 282 | 416 | 1.342 | 604 | - | 5.287 | 3.956 |
| Të tjera | 1.878 | 3.794 | 10.208 | 14.755 | 6.956 | 10.525 | 37.339 | 52.577 |
| Gjithsej | 23.112 | 34.856 | 125.380 | 176.630 | 52.134 | 67.175 | 271.339 | 354.209 |

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milione lekë), Qershor 2021

| Grup-mallrat | Eksporte | | | | Importe | | | |
|---------------------------------|---------------|---------------|----------------|----------------|---------------|---------------|----------------|----------------|
| | Qershor 2020 | Qershor 2021 | Jan.-Qer. 2020 | Jan.-Qer. 2021 | Qershor 2020 | Qershor 2021 | Jan.-Qer. 2020 | Jan.-Qer. |
| Gjithsej | 23.112 | 34.856 | 125.380 | 176.630 | 52.134 | 67.175 | 271.339 | 354.209 |
| Ushqime, pije, duhan | 3.650 | 4.505 | 18.500 | 21.395 | 9.625 | 11.079 | 53.945 | 57.784 |
| Minerale, lëndë djegëse, en,el, | 2.894 | 7.529 | 18.473 | 35.013 | 3.845 | 6.256 | 24.837 | 31.401 |
| Produkte kimike dhe plastike | 583 | 891 | 3.359 | 4.721 | 7.833 | 9.312 | 41.937 | 54.485 |
| Lëkurë dhe artikujt prej tyre | 162 | 162 | 1.049 | 1.308 | 1.177 | 1.379 | 6.071 | 7.279 |
| Prodhime druri dhe letre | 646 | 826 | 3.944 | 4.095 | 1.813 | 2.594 | 10.814 | 12.739 |
| Tekstile dhe këpucë | 9.443 | 10.554 | 48.265 | 56.219 | 6.864 | 8.074 | 32.634 | 42.766 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 3.495 | 6.945 | 17.386 | 34.851 | 7.614 | 10.185 | 36.949 | 51.288 |
| Makineri, pajisje dhe pj, këmb, | 1.540 | 2.609 | 10.628 | 14.037 | 11.197 | 15.378 | 54.370 | 80.842 |
| Të tjera | 698 | 835 | 3.778 | 4.991 | 2.167 | 2.917 | 9.783 | 15.624 |

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2021

| | Itali | | Kosovë | | Spanjë | | Greqi | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|--------------|---------------|--------------|---------------|
| | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 |
| Gjithsej | 57.098 | 75.281 | 10.343 | 17.251 | 8.438 | 11.776 | 5.704 | 10.027 |
| Ushqim, pije duhan | 4.147 | 5.151 | 1.899 | 2.133 | 587 | 780 | 1.350 | 1.816 |
| Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike | 581 | 864 | 1.546 | 4.225 | 7.184 | 10.644 | 393 | 3.289 |
| Produkte kimike dhe plastike | 918 | 1.244 | 991 | 1.492 | 73 | 17 | 245 | 385 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 882 | 874 | 3 | 9 | 71 | 2 | 9 | 9 |
| Prodhime druri dhe letre | 2.336 | 2.794 | 358 | 380 | 2 | 55 | 636 | 606 |
| Tekstile dhe këpucë | 35.580 | 44.419 | 60 | 92 | 428 | 208 | 2.331 | 2.586 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 5.839 | 10.487 | 4.333 | 7.489 | 73 | 57 | 548 | 1.035 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 5.240 | 7.034 | 340 | 699 | 7 | 11 | 27 | 44 |
| Të tjera | 1.575 | 2.414 | 811 | 732 | 13 | 2 | 163 | 257 |

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë), Qershor 2021

| | Itali | | Turqi | | Kinë | | Greqi | |
|--|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|---------------|
| | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 | 2020 | 2021 |
| Gjithsej | 66,014 | 91,415 | 25,019 | 39,143 | 23,141 | 31,071 | 25,257 | 27,105 |
| Ushqim, pije duhan | 9,467 | 11,123 | 2,771 | 3,405 | 339 | 463 | 7,848 | 7,926 |
| Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike | 1,829 | 5,052 | 1,412 | 2,651 | 4 | 8 | 4,766 | 3,574 |
| Produkte kimike dhe plastike | 8,858 | 11,593 | 4,047 | 5,327 | 2,600 | 4,460 | 3,742 | 4,382 |
| Lëkurë dhe artikuj prej lëkure | 4,973 | 6,066 | 92 | 172 | 228 | 326 | 13 | 17 |
| Prodhime druri dhe letre | 2,782 | 2,988 | 1,329 | 1,562 | 379 | 344 | 1,626 | 1,811 |
| Tekstile dhe këpucë | 14,640 | 20,329 | 6,544 | 8,646 | 4,153 | 5,501 | 1,665 | 1,660 |
| Materiale ndërtimi dhe metale | 8,100 | 12,150 | 4,596 | 9,632 | 3,136 | 2,498 | 3,572 | 5,086 |
| Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi | 13,283 | 18,920 | 3,402 | 5,268 | 10,051 | 14,469 | 1,337 | 1,660 |
| Të tjera | 2,083 | 3,194 | 826 | 2,481 | 2,251 | 3,001 | 687 | 989 |

Metodologjia

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv

Vlera F,O,B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor

Vlera C,I,F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri